



FLET PËR "EPOKËN E RE", ARBËRESHA LOXHA-STUBLLA

FAQE 4-5

MUNGESA E KONSENSUSIT POLITIK PO DËMTON PROCESIN INTEGRUES TË KOSOVËS



Drejtoresha ekzekutive e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Arbëresha Loxha-Stublla, ka vlerësuar se mungesa e konsensusit politik është duke e dëmtuar Kosovën në rrugën e saj evropiane. Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se jostabiliteti institucional po ndikon në ngecjen e reformave të rëndësishme në sektor publik. Arbëresha Loxha-Stublla ka bërë me dije se për të avancuar në

këtë proces Kosovës i duhet stabilitet institucional. Sa i përket raportit të KE-së për Kosovën për vitin 2020, ajo ka thënë se ky raport nuk vëren asnjë përparim thelbësor sa iu përket reformave integruese të Kosovës

VARHELYI: DUHET T'I BINDIM SHTETET PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN



Komisionari i BE-së për Zgjerim dhe Politikë të Fqinjësisë, Oliver Varhelyi, në fjalën e tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, vuri në pah se përkushtimi i BE-së për integrimin e vendit të Kosovës dhe të rajonit mbetet prioritet edhe në të ardhmen. Lidhur me reformat e parapara për integrim në BE, ai ka kërkuar konsensus politik në Kuvendin e Kosovës për këtë proces. Ndërkaq sa i përket liberalizimit të vizave, Varhelyi ka thënë se duhet të binden të gjitha shtetet anëtare të BE-së

FAQE 3

KUVENDI EDHE NJË HERË DËSHTON TA VOTOJË PROJEKTLIGJIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE

OPINION

ME KË E KA FUSHATËN KËTË HERË EDI RAMA?

F. 11

Shkruan:
Bedri ISLAMI



AKTUALE

FALEN GJOBAT E VENDOSURA PËR COVID-19 NË SHQIPËRI

F. 2

MBETET NË FUQI MASA E PARABURGIMIT NDAJ 30 TË ARRESTUARVE NË RASTIN "KARAÇEVA"

F. 6

TRUMPI REFUZON TË MARRË PJESË NË DEBAT VIRTUAL ME BIDENIN

F. 2

EKONOMI

RAPORTI I PROGRESIT NJEH REFORMAT E NDËRMARRA NGA BQK-JA

F. 9

PANDEMIA COVID-19 SHKAKTOI DËME NË INDUSTRIJËN E HORECA-S

F. 9



KULTURË

LOUISE GLUCK FITON ÇMIMIN NOBEL PËR LETËRSI

F. 13



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepgisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi refuzon të marrë pjesë në debat virtual me Bidenin

WASHINGTON, 8 TETOR - Debat i dytë në mes të presidentit amerikan Donald Trump dhe kandidatit demokrat për president, Joe Biden, do të mbahet virtualisht, ka njoftuar Komisioni për Debate Presidenciale. Megjithatë, presidenti

Trump ka thënë se nuk do të marrë pjesë në një format të tillë debati. "Nuk do të marr pjesë në debat virtual. Nuk do ta humb kohën time në debat virtual", është cituar të ketë thënë ai për "Fox Business". Debat i dytë në mes të dy rivalëve është

planifikuar të mbahet të enjten e javës së ardhshme. Ky vendim vjen pasi presidenti Trump vazhdon të trajtohet për koronavirus në Shtëpinë e Bardhë. Mjeku i tij ka thënë se ai nuk ka pasur simptoma për më shumë se 24 orë.



Vendet evropiane po përballen me rritje të rasteve me Covid-19

PRAGË, 8 TETOR - Republika Çeke raportoi një rekord prej 5 335 rastesh të reja me koronavirus, kurse Gjermania shënoi më shumë se 4 058 raste, thanë zyrtarët shëndetësorë qeveritarë në këto dy vende të Bashkimit Evropian.

Disa vende të tjera evropiane kanë shprehur shqetësime për rritjen e rasteve të reja me Covid-19. Republika Çeke me 10.7 milionë banorë ka regjistruar një rritje të shpejt të shifrave të të infektuarve në dy javët e fundit.

Gjermania paralajmëroi se vendi mund ta humbasë kontrollin ndaj pandemisë pasi shifra e 8 tetorit është gati dyfish më e lartë se ajo e një dite më parë.

Në kulmin e pandemisë në fund të marsit dhe fillim të prillit, Gjermania shënonte më shumë se 6 000 raste të reja në ditë. Më pas numri i rasteve të reja filloi të shënojë ulje të ndjeshme, por situata ndryshoi përsëri në korrik.

Numri i të vdekurve në Republikën Çeke u rrit në 829



më 7 tetor, ndërsa Gjermania arriti në shifrën 9 571. Italia, e cila po ndërmerr hapa për ta mbajtur situatën nën kontroll, vendosi masën e mbajtjes së maskës në ambient të hapur dhe gjoha deri në 1 000 euro për shkelësit e këtij rregulli.

Vendi, i cili u godit rënd në fillim të pandemisë, po përballlet me një rritje të vazhdueshme të numrit të të infektuarve që nga fillimi i gushtit, por shkalla e përgjithshme është aktualisht ndër më të ulëtat në Evropë.

Falen gjobat e vendosura për Covid-19 në Shqipëri

TIRANË, 8 TETOR - Këshilli i Ministrave i Shqipërisë përmes një akti normativ ka vendosur që të falen të gjitha gjobat e vendosura për shkeljen e rregullave gjatë pandemisë. Këto gjoba janë dhënë prej periudhës së 17 prillit deri më 7 tetor të vitit 2020 dhe kanë qenë kryesisht për personat që kanë thyer karantinën, apo që nuk u janë përmbajtur rregullave të vendosjes së maskës dhe grumbullimeve në ambiente të mbyllura. "Të gjitha institucionet shtetërore, të cilat kanë ushtruar autoritetin e vendosjes së masës administrative me gjobë, duhet t'i përgatisin listat e subjekteve ndaj të cilave është vendosur masa administrative me gjobë, duke përfshirë shumën si dhe të dhënat e nevojshme për kthimin e saj brenda datës 30 tetor 2020", thuhet në vendimin e marrë nga Këshilli i Ministrave.

Po ashtu, është marrë



vendim që të gjithë ata persona që i kanë paguar këto gjoba t'i rikthehen paratë në llogari bankare. "Në rastin e gjobave të vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 2, të nenit 1, të këtij akti, të gjitha strukturat

përkatese duhet t'i dërgojnë listat e subjekteve ndaj të cilave është vendosur masa administrative. Mënyra dhe rregullat e hollësishme për zbatimin e faljes dhe kthimin e shumave të paguara, sipas përcaktimeve të këtij akti normativ, përcaktohen nga

këshilli bashkiak", thuhet në vendimin e marrë nga Këshilli i Ministrave. Gjithashtu, do të kthehen edhe licencat dhe mjetet e bllokuara për shkak të shkeljes së karantinës. "Të gjitha masat administrative me karakter ndëshkues,

përjashtuar ato të parashikuara në nenin 2 të këtij akti normativ, si lejet/licencat dhe mjetet e bllokuara, duhet të kthehen brenda datës 15 nëntor 2020 te subjekti përfitues. Ngarkohen titullarët e secilit prej institucioneve shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, që kanë vendosur masa administrative sipas këtij neni, t'i nxjerrin udhëzimet përkatese për përcaktimin e mënyrës së kthimit të detyrimit të falur", thuhet në vendimin e marrë nga Këshilli i Ministrave.

Në Shqipëri janë hequr thuajse të gjitha masat e vendosura për ta ndaluar përhapjen e pandemisë së koronavirusit dhe autoritetet e kanë lënë në dorë të qytetarëve të jenë vigjilentë dhe të kenë kujdes për veten. Nga sëmundja Covid-19 deri më tani në Shqipëri është raportuar për 9 100 raste të infektimit. Prej tyre, 407 pacientë kanë vdekur.

Louise Gluck fiton Çmimin Nobel për Letërsi

NJU JORK, 8 TETOR - Poetja amerikane Louise Gluck fitoi Çmimin Nobel në Letërsi për vitin 2020. Komiteti i Nobelit

ka njoftuar në vendimin e tij se "zëri i saj i pagabueshëm poetik e bën ekzistencën individuale universale". Çmimi

Nobel vjen me një medalje të artë dhe një shpërblim prej 1.1 milion dollarësh. Vitin e kaluar Çmimi Nobel në

Letërsi iu nda shkrimtarit austriak Peter Handke, por ky vendim kishte ngjallur kritika të shumta.



Komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, ka qëndruar për vizitë në Kosovë

Varhelyi: Duhet t'i bindim shtetet për liberalizimin e vizave për Kosovën

Komisionari i BE-së për Zgjerim dhe Politikë të Fqinjësisë, Oliver Varhelyi, në fjalën e tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, vuri në pah se përkushtimi i BE-së për integrimin e vendit të Kosovës dhe të rajonit mbetet prioritet edhe në të ardhmen. Lidhur me reformat e parapara për integrim në BE, ai ka kërkuar konsensus politik në Kuvendin e Kosovës për këtë proces. Ndërkaq sa i përket liberalizimit të vizave, Varhelyi ka thënë se duhet të binden të gjitha shtetet anëtare të BE-së

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 TETOR - Komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, ka thënë të enjten se duhen bindur shtetet anëtare të BE-së për t'i liberalizuar vizat me Kosovën. "Vlerësimi ynë mbetet se i keni përmbushur të gjitha kushtet, por nuk mjafton vetëm vlerësimi ynë, duhet t'i bindim shtetet anëtare", ka thënë ai gjatë adresimit të tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me rastin e vizitës së tij në Kosovë. Ai vuri në pah se përkushtimi i BE-së për integrimin e vendit të Kosovës dhe të rajonit mbetet prioritet edhe në të ardhmen. Varhelyi ka theksuar se Bashkimi Evropian tani në fokus ka mbështetjen afatgjatë në rrafshin socio-ekonomik jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Ai ka thënë se përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të punojnë për të arritur një marrëveshje

për zhvillimin e tregut rajonal. "Kjo [marrëveshje] do ta shndërrojë rajonin në një vend atraktiv për investitorët. Do të thotë është në interesin tonë strategjik ta sjellim Ballkanin Perëndimor më afër BE-së. Ekziston një zbrastirë e madhe mes vendit tuaj, rajonit dhe BE-së. Aq më shpejt që e mbyllim këtë hapësirë, aq më shpejt fillojmë të krijojmë një ekonomi të qëndrueshme dhe të fuqishme", është shprehur Varhelyi.

Në vijim, lidhur me reformat e parapara për integrim në BE, ai kërkoi konsensus politik në Kuvend sepse, ato, tha ai, janë interes strategjik për Kosovën. Për t'i arritur objektivat e integritetit të plotë të Kosovës në BE, Varhelyi bëri thirrje që kjo të bëhet në bashkëpunim të ngushtë dhe të përkushtuar.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalën mikpritëse të saj për komisionarin e lartë të BE-së, Oliver Varhelyi, ka thënë se "Kosova nuk pranon që

dialogu të përfundojë me kufij të tjerë, përpos atyre aktualë". Ajo ka theksuar se qytetarët e Kosovës nuk pranojnë një republikë tjetër brenda aktuale. "Për republikën tonë, roli i BE-së është i patjetërsueshëm, anëtarësimi në BE mbetet një ndër prioritetet themelore të republikës sonë. Njësoj edhe në procesin e dialogut, roli i BE-së është i rëndësishëm së veçantë në bashkëpunim me ShBA-në. Qytetarët e Kosovës e kanë bërë të qartë se në dialog nuk pranojnë asnjë ndryshim të kufijve e as defunksionalizim të shtetit tonë", ka thënë Osmani. Ajo ka theksuar se mosliberalizimi i vizave për

Kosovën nuk i bën nder BE-së. Osmani ka shtuar se tashmë kushtet e kërkuara janë plotësuar. "Edhe institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme që rruga drejt BE-së kërkon përkushtim përtej fjalësh, kërkon koordinim dhe përpikëri në zbatim të obligimeve tona. Prej një dekade institucionet e Kosovës jo vetëm se kanë bërë përpjekje për t'i përmbushur kriteret e kërkuara për liberalizim vizash, por i kanë plotësuar që të gjitha", ka thënë Osmani.

Komisionari për Fqinjësi dhe Zgjerim të Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi, ka zhvilluar edhe një takim me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti. Hoti e Varhelyi kanë biseduar për zhvillimet e përgjithshme në vend dhe për projektet investive të Bashkimit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor, ku përfshihet edhe Republika e Kosovës me projektet e prezantuara në këtë plan të investimeve.

Kryeministri Hoti dhe komisionari Varhelyi kanë mbajtur edhe një konferencë të përbashkët me gazetarë. "Ishim të nderuar që të mirëpresim në Prishtinë komisionarin Varhelyi dhe bashkëpunëtorët e tij, që të sjellin në Prishtinë një lajm fantastik, një lajm shumë të madh për Ballkanin Perëndimor dhe për Kosovën, të planit të investimeve dhe të rimëkëmbjes ekonomike për Ballkanin Perëndimor në vlerë totale prej 28 miliardë

eurosh, prej të cilave 9 miliardë janë grante, që u jepen vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky është lajmi kryesor që komisionari sot sjell në Prishtinë, pas plot bisedave që kemi pasur në Bruksel në disa takime radhazi, për të cilën e falënderoj komisionarin dhe bashkëpunëtorët e tij", ka thënë Hoti.

Ai ka bërë me dije se e ka siguruar komisionarin Varhelyi që Kosova është e vendosur për ta çuar përpara reformën e agjendave evropiane. "Ne tanimë e kemi pranuar raportin për Kosovën nga Komisioni Evropian, ku jepen vlerësime, sigurisht për sfidat që ka vendi, por edhe vlerësimet për vendosmërinë e kësaj qeverie për t'i çuar përpara këto reforma dhe për t'i prekur sfidat kryesore nga këndvështrimi i Bashkimit Evropian. Më vjen mirë që komisionari dhe Bashkimi Evropian e vlerësojnë këtë gatishmëri të qeverisë për t'i adresuar këto sfida. E them me kënaqësi që në katër muajt e qeverisjes sonë fjalën korrupsion e kemi larguar nga diskursi publik dhe kemi treguar vendosmëri të madhe në luftimin e krimit të organizuar", është shprehur kryeministri Hoti.

Varhelyi po viziton vendet e Ballkanit Perëndimor për ta prezantuar planin e investimeve ekonomike për Ballkanin Perëndimor dhe raportet e reja vjetore mbi përparimin në procesin e integritetit evropian.





Flet për “Epokën e re”, Arbëresha Loxha-Stublla

MUNGESA E KONSENSUSIT POLITIK PO DËMTON PROCESIN INTEGRUES TË KOSOVËS

Drejtoresha ekzekutive e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Arbëresha Loxha-Stublla, ka vlerësuar se mungesa e konsensusit politik është duke e dëmtuar Kosovën në rrugën e saj evropiane. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ajo ka thënë se jostabiliteti institucional po ndikon në ngecjen e reformave të rëndësishme në sektor publik. Arbëresha Loxha-Stublla ka bërë me dije se për të avancuar në këtë proces Kosovës i duhet stabilitet institucional. Sa i përket raportit të KE-së për Kosovën për vitin 2020, ajo ka thënë se ky raport nuk vëren asnjë përparim thelbësor sa iu përket reformave integruese të Kosovës

reformave për përafrim me BE-në”, ka theksuar Loxha-Stublla. Në këtë intervistë ajo ka folur edhe për raportin e vendit për vitin 2020.

Sipas saj, ky raport nuk sjell ndonjë gjë të re sa i përket vlerësimit të performancës dhe defekteve të institucioneve të Republikës së Kosovës. “Ky raport nuk vëren asnjë progres thelbësor sa iu përket reformave integruese të Kosovës. I njëjti nuk lavdëron Kosovën për asnjë reformë thelbësore të ndërmarrë gjatë këtij viti sa i përket përafrimit me BE-në dhe kjo dëshmon se Qeveria e Kosovës ka dështuar të ecë përpara në rrugën integruese, kryesisht për shkak të pafuqisë politike dhe mungesës së aftësisë për t’i përmbushur kërkesat dhe prioritetet e caktuara në këtë drejtim”, është shprehur ajo, duke shtuar se institucionet e Kosovës duhet t’i marrin seriozisht vërejtjet e këtij raporti. “Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t’i trajtojë me

shumë kujdes dhe seriozitet të gjitha të gjeturat e pasqyruara në këtë raport dhe jo të mbetet ky një vlerësim anësor i situatës aktuale në Kosovë. Institucionet duhet të kuptojnë që e vetmja rrugë e duhur për Kosovën është ajo e përafrimit me BE-në, ngjashëm sikurse të gjitha vendet e rajonit dhe se për këtë kërkohet një përkushtim përtej koalicioneve politike dhe interesave të ngushta të tyre”, ka deklaruar Loxha-Stublla.

“Epoka e re”: Znj. Loxha, Komisioni Evropian ka publikuar raportin vjetor për Kosovën 2020. Cilat janë gjetjet kryesore të këtij raporti?

Loxha-Stublla: Në përgjithësi, Raporti i Vendi për vitin 2020 nuk sjell ndonjë gjë të re sa i përket vlerësimit të performancës dhe defekteve të institucioneve të Republikës së Kosovës. Ky raport nuk vëren asnjë progres thelbësor sa iu përket reformave integruese të Kosovës. I njëjti nuk lavdëron

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 TETOR - Drejtoresha ekzekutive e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Arbëresha Loxha-Stublla, ka deklaruar se mungesa e vazhdueshme e vullnetit dhe stabilitetit politik në Kosovë po ndikon në procesin e integritetit të vendit në BE. Ajo ka vlerësuar se mungesa e konsensusit afatgjatë politik ka ndikuar në dëmtimin e procesit integrues të Kosovës.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Loxha-Stublla ka deklaruar se kjo po ndikon në ngecjen e reformave të rëndësishme në sektor publik. “Mungesa e vazhdueshme e vullnetit dhe stabilitetit politik, koalicionet e brishta dhe mungesa e konsensusit afatgjatë politik janë disa nga aspektet themelore që kanë dëmtuar procesin integrues të Kosovës duke pamundësuar krijimin e një qëndrueshmërie stabile për t’i adresuar reformat e ndryshme qoftë të procesit

integrues, apo edhe reformat e tjera të rëndësishme në sektorë të ndryshëm publikë”, ka deklaruar Loxha-Stublla. Ajo ka bërë me dije se për të avancuar në këtë proces Kosovës i duhet stabilitet institucional. “Jeta jostabile institucionale ka bërë që Kosova ta zhvendosë fokusin nga proceset reformuese shumë të rëndësishme, duke bërë kështu të pamundshme krijimin e një stabiliteti institucional që do të krijonte mekanizma funksionalë për adresimin e



Kosovën për asnjë reformë thelbësore të ndërmarrë gjatë këtij viti sa i përket përafrimit me BE-në dhe kjo dëshmon se Qeveria e Kosovës ka dështuar të ecë përpara në rrugën integruese, kryesisht për shkak të pafuqisë politike dhe mungesës së aftësisë për t'i përmbushur kërkesat dhe prioritetet e caktuara në këtë

drejtim. Madje raporti thotë se Kosova ende nuk ka arritur t'i konsolidojë mjaftueshëm kuadrot institucionale të cilat do menaxhonin në mënyrë sistematike dhe të mirëfilltë çdo kriter të procesit të integrimit. Përfundimisht, Raporti i Vendit vlerëson se Kosova nuk ka seriozitet për adresimin e instrumenteve të brendshme të procesit integrues, madje edhe prioritetet e dikurshme sikurse Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) apo Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) nuk janë tashmë pjesë thelbësore e debatit të brendshëm dhe ato më shumë shërbejnë si fasadë për të përmbushur një detyrim formal sesa që është arritur ndonjë impakt minimal në reformat evropiane, apo mirëqenien qytetare. Ky raport, ndër të tjera, vlerëson se Kosova nuk ka arritur të çojë përpara asnjë reformë thelbësore në sistemin e drejtësisë, i cili vazhdon të mbetet i kapur nga politika dhe larg performancës së dëshiruar, sidomos në trajtimin e rasteve të profilin të lartë. Raporti rithekson sikur vitin e kaluar që korrupsioni është prevalent gjithandej. Po ashtu, raporti gjen progres të limituar në fushën e administratës publike dhe vlerëson negativisht pezullimin e dy ligjeve kryesore që rregullojnë këtë fushë, të cilat së fundmi u pezulluan nga Gjykata Kushtetuese. Për më tepër, Kosova karakterizohet me emërime të larta të pabazuara në meritë dhe procese rekrutuese të diskutuara që, në thelb, shërbejnë për t'i akomoduar interesat e partive në pushtet. Në anën tjetër, Kuvendi i Kosovës vazhdon të mbetet objekt i përçarjeve të thella dhe aspak aktiv në rolin

mbikëqyrës të tij, duke mos arritur që as minimalisht ta implementojë agjendën legislative të paracaktuar. Mungesa e një strukture të mirëfilltë të shpenzimeve publike, pamundësia e të bërit biznes për shkak të kontrollit të madh të interesave politike, reprezentimi i mangët i gruas në politikëbërje dhe mungesa e transparencës në financimin e partive politike janë disa aspekte të rëndësishme të ngritura si shqetësime në raportin e vendit për vitin 2020.

“Epoka e re”: *Duke pasur parasysh faktin se gjatë kësaj kohe janë ndërruar dy qeveri, a ka mundur të bëjë më shumë Kosova në rrugën e saj integruese?*

Loxha-Stublla: Mungesa e vazhdueshme e vullnetit dhe stabilitetit politik, koalicionet e brishta dhe mungesa e konsensusit afatgjatë politik janë disa nga aspektet themelore që kanë dëmtuar procesin integrues të Kosovës duke pamundësuar krijimin e një qëndrueshmërie stabile për t'i adresuar reformat e ndryshme, qoftë të procesit integrues, apo edhe reformat e tjera të rëndësishme në sektorë të ndryshëm publikë. Jeta jostabile institucionale ka bërë që Kosova ta zhvendosë fokusin nga proceset reformuese shumë të rëndësishme, duke bërë kështu të pamundshme krijimin e një stabiliteti institucional që do të krijonte mekanizma funksionalë për adresimin e reformave për përafrim me BE-në. Kosova duhet të angazhohet më tutje në krijimin e mekanizmave adekuatë institucionale të cilët shkojnë përtej interesave politike dhe që do të mundësojnë

implementimin sistematik të kriterëve dhe reformave të kërkuara nga Bashkimi Evropian, përfshirë këtu instrumentet ekzistuese si ERA dhe PKZMSA.

“Epoka e re”: *Çka duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për t'i adresuar gjetjet e këtij raporti?*

Loxha-Stublla: Siç thashë në fillim, Raporti për Vendin i këtij viti nuk ka sjellë asnjë të re për sa i përket progresit në rrugën integruese të Kosovës dhe mendoj se i njëjti do të vazhdojë të neglizhohet nga kjo qeveri, siç është neglizhuar nga ato parapraket në 10 vjetët e fundit. Raporti vazhdon ta tërheqë vërejtjen se Qeveria e Kosovës nuk ka seriozitetin e duhur dhe vullnetin politik për adresimin e instrumenteve të procesit integrues dhe se shumica e vendimeve të ndërmarra bëhen kryesisht në baza ad-hoc. Për më tepër, vërehet një bashkëpunim tejte i dobët horizontal ndërmjet institucioneve qeveritare, e shpeshherë i çakorduar në rrafshin praktik. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'i trajtojë me shumë kujdes dhe seriozitet të gjitha të gjeturat e pasqyruara në këtë raport dhe jo të mbetet ky një vlerësim anësor i situatës aktuale në Kosovë. Institucionet duhet të kuptojnë që e vetmja rrugë e duhur për Kosovën është ajo e përafrimit me BE-në, ngjashëm sikurse të gjitha vendet e rajonit dhe se për këtë kërkohet një përkushtim përtej koalicioneve politike dhe interesave të ngushta të tyre.

“Epoka e re”: *Në këtë raport Komisioni Evropian ka ripërsëritur qëndrimin se*

Kosova ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave, por nuk flet për kohën se kur mund të ndodhë vendimmarrja për këtë proces. Cilat janë gjasat që këtë vit të kemi ndonjë vendim të Këshillit të BE-së për liberalizim të vizave?

Loxha-Stublla: E vërtetë. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2020 edhe një herë konfirmon që Kosova ka përmbushur kriteret minimale për liberalizimin e vizave dhe një gjë e tillë është konfirmuar edhe nga Parlamenti Evropian. Por i njëjti nuk jep një afat të caktuar se kur kjo mund të ndodhë ngaqë një gjë e tillë tashmë është në dorë të shteteve anëtare të BE-së.

“Epoka e re”: *Për këtë proces institucionet tona po e kritikojnë BE-në, duke përmendur faktin se Kosova ka përmbushur kushtet për këtë proces. A po tregohet e padrejtë BE-ja në këtë aspekt me Kosovën?*

Loxha-Stublla: Parlamenti Evropian ka konfirmuar dy herë radhazi se tashmë Kosova ka përmbushur kriteret e nevojshme për liberalizim dhe se BE-ja duhet ta gjejë mënyrën që shtetet anëtare unanimisht të procedojnë tutje dhe ta mbajnë premtimin e dhënë. Kosova duhet të bëjë përpjekje që në bashkëpunim me vendet skeptike të gjejë mënyra për t'i adresuar brengat e tyre karshi Kosovës. Një mundësi ka qenë krijimi i grupeve që do t'i identifikonin dhe më pas adresonin problemet e identifikuar nga vendet të cilat janë kundër liberalizimit të vizave për Kosovën. Deri më tani, asgjë konkrete nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.

VESELI: QEVERIA NUK DUHET TË UDHËHIQET ME INATE

KAMENICË, 8 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i ka bërë thirrje qeverisë që të mos udhëheqë me inate, por të bisedojë me opozitë për t'u tejkaluar situata ekonomike në të cilën gjendet Kosova. “Të zhblllokohet qeveria. Nuk duhet të udhëheqë me inat. Duhet të ulet bashkërisht me ne, ta tejkalojë situatën ekonomike të cilën e kemi bashkërisht. Të mos prodhojë lajme të cilat kanë vetëm qëllim social, duke u munduar të joshë përmes Trustit Pensional, për arsye se nuk është trusti e vetmja zgjidhje, është prodhimi, këto fabrika, rrotullimi i këtyre makinerive ajo që e zgjedh problemin ekonomik dhe social në Republikën e Kosovës”, ka thënë Veseli. Këto komente Veseli i bëri gjatë vizitës në fabrikën e pelenave në

Topanicë të Kamenicës. Ai e ka cilësuar të dhimbshme që pronari i kësaj fabrike, i cili ka ardhur nga jashtë që të investojë në Kosovë, të mos përkrahet nga qeveria. Veseli ka thënë se ndërmarrësit kanë mbushur buxhetin e Republikës së Kosovës, mirëpo qeveria ka dështuar për përkrahje të tyre. “Është hera e parë pas 21 vjetëve që këta ndërmarrës të cilët e kanë bërë buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës, e kanë mbushur me taksat e tyre, me punën e tyre të ndershme, që kanë pasur nevojë nga shteti, nga qeveria, edhe këtë herë është duke dështuar. Vërtet është e dhimbshme edhe nga ky vend, nga kjo fabrikë e pelenave për fëmijë, ‘Tina’, një prodhim jashtëzakonisht cilësor i cili ka arritur të ketë plasmanin në gjithë Republikën e Kosovës, por



edhe jashtë, në Maqedoninë e Veriut”, ka thënë Veseli. Veseli ka shtuar thotë se është rast i rrallë kur opozita është e gatshme ta përkrahë një pako të rimëkëmbjes ekonomike. “Një mentalitet vërtet bllokues nga dy qeveritë, edhe ajo paraprake e

cila qëndroi vetëm 52 ditë, edhe kjo e cila po qëndron këtu. Po qëndron lodhshëm. Është rast unik në botë ndoshta kur opozita është e gatshme të përkrahë një pako të rimëkëmbjes ekonomike, në fakt edhe të propozojmë si Partia

Demokratike e Kosovës dhe qeveria, do të thotë të jetë e bllokuar për gjashtë muaj. Gjashtë herë ta dërgojë në Kuvend, mos të ulet me odat ekonomike, mos të ulet me ndërmarrësit si Zijadini dhe të tjerët”, ka thënë Veseli.

Kuvendi edhe një herë dështon ta votojë Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Kuvendi i Kosovës sërish ka dështuar ta votojë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19. Ky projektligj është paraqitur para deputetëve të Kuvendit të Kosovës në seancën e së enjtes për herë të gjashtë.

Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike, që më 22 korrik u miratua në Qeverinë e Kosovës, kap vlerën e 385 milionë eurove.

Ky projektligj synon që përmes politikave fiskale dhe monetare t'u ndihmojë bizneseve pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Votimi i këtij projektligji do t'u mundësonte qytetarëve kontributpagues të tërheqin 10 për qind të mjeteve nga llogaria e tyre në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Deri më tani vlera e

mjeteve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës ka arritur në mbi 2 miliardë euro me rreth 690 mijë kontributpagues. Kjo i bie se vlera e përgjithshme që do të mund të tërhiqej nga Fondi është rreth 200 milionë euro, mjete këto që, sipas zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, janë konsideruar se do ta stimulonin kërkesën agregate në treg.

Shumica e bizneseve në Kosovë, gati në të gjithë sektorët, kanë raportuar vlera të mëdha të humbjeve financiare dhe zvogëlim të kapaciteteve prodhuese, nga masat e marra nga qeveria më 13 mars për parandalimin e pandemisë.

Për ta ndihmuar sektorin privat, Qeveria e Kosovës më 28 shtator ka ndarë rreth 87 milionë euro për bizneset private, për t'i rikuperuar



humbjet që kanë pësuar nga pandemia Covid-19, për qytetarët në nevojë, për disa ministri dhe të tjera.

Nga kjo vlerë, 60 milionë euro u ndan për bizneset të cilat do të

përfitojnë varësisht nga numri i punëtorëve që kanë pasur të regjistruar në muajin dhjetor të vitit 2019. Përfaqësuesit e bizneseve në vazhdimësi u kanë bërë thirrje autoriteteve të

Kosovës që sa më shpejt të ndihmojnë në rimëkëmbjen ekonomike, pasi që çdo vonesë, sipas tyre, do të sillte probleme më të mëdha për bizneset dhe rrezik të falimentimit të tyre.

Mbetet në fuqi masa e paraburgimit ndaj 30 të arrestuarve në rastin “Karaçeva”



GJILAN, 8 TETOR (ER) - Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën e avokatit mbrojtës kundër caktimit të masës së paraburgimit prej një muaji ndaj 30 të pandehurve në rastin “Karaçeva”. Gjykata Themelore e Gjilanit më 20 shtator ka marrë vendim që të pandehurit F. L. dhe 29 tjerëve t'u caktohet masa e paraburgimit prej një muaji, saktësisht deri më 17-18 tetor.

Gjykata e Apelit ka vendosur që kjo masë të mbetet në fuqi. “Gjykata e Apelit vlerësoi se meqenëse ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit i kanë kryer veprat penale për të cilat po dyshohen, ka bazë ligjore për caktimin e kësaj mase, ngaqë ekzistojnë arsye të forta për të besuar, se me gjetjen e tyre në liri, ata do të mund të ndikojnë në prova apo dëshmitarë dhe këtë formë, ta pengojnë rrjedhën normale të procedurës penale, ose mund ta

përsërisin veprën penale. Gjykata i ka shqyrtuar konform ligjit edhe masat e tjera të cilat i parasheh Kodi i Procedurës Penale, por ka konstatuar se ato nuk janë të mjaftueshme për zbatimin me sukses të procedurës penale”, thuhet në njoftimin e Gjykatës së Apelit.

Sipas prokurorisë, i pandehuri F. L. dyshohet se ka kryer veprat penale “Kontrabandimi me mallra” dhe “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK). Të pandehurit H.K., S.K., I.S., F.K., A.K., F.Z., R.TH., S.G., S.N., S.M., Z.A. D.S., A.Th., A.S., B.S., F.S., A.S., N.K., S.D., B.S., F.S., Sh.S., E.K., F.S., V.S. po dyshohen për veprën penale “Kontrabandimi me mallra” sipas KPRK-së. Ndërsa të pandehurit Y.F., RR.G., N.Ç. dhe L.G., për veprën penale “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” sipas KPRK-së.

Shpallen zgjedhjet për anëtarë të KPK-së nga radhët e prokurorive themelore

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Nën masat e mbrojtjes nga pandemia dhe përmes komunikimit në distancë, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi i tij, Bahri Hyseni, ka mbajtur takimin e 186-të me radhë. Ky takim ka filluar me shqyrtimin e dy draftregulloreve. Anëtarët e KPK-së, pas shqyr-

timit, kanë miratuar Rregulloren për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe Rregulloren për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Po në këtë takim nga KPK-ja është marrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga

radhët e prokurorive themelore të Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Ferizajt, Gjakovës, Mitrovicës dhe Gjilanit. Pas vendimit për shpalljen e zgjedhjeve është themeluar Komisioni Zgjedhor, i cili do të udhëhiqet nga Agron Beka, anëtar i KPK-së nga radhët e fakulteteve juridike.



Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 49 të shëruar dhe 33 raste të reja me Covid-19

Asnjë i vdekur dhe 33 raste të reja me Covid

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë nuk ka vdekur asnjë person nga Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë paraqitur 33 raste të reja me Covid-19 dhe janë shëruar 46 persona. “Numri total i rasteve pozitive është 15 971 raste nga 73 287 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 638 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 46 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 189 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 144”, ka njoftuar IKShPK-ja

“Epoka e re”

PRISHTINË, 8 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë paraqitur 33 raste të reja me Covid-19 dhe janë shëruar 46 persona. Po ashtu, IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka vdekur asnjë person nga Covidi. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 711 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 33 raste pozitive. Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total

i rasteve pozitive është 15 971 raste nga 73 287 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 638 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 46 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 189 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 144”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke bërë me dije se Prishtina prin me numrin e rasteve të reja me koronavirus. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 14 raste, komuna Gjilan 3 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Viti 3 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Fushë-Kosovë, Gjakovë, Hani Elezit, Kamenicë, Klinë, Pejë, Skenderaj, Suharekë dhe Vushtri. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!”, ka njoftuar IKShPK-ja.



IKShPK-së i shtohen edhe dy aparatura për kryerjen e testeve të Covidit

Në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës janë shtuar edhe dy aparatura për kryerjen e testeve PCR për Covid 19. Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se është lajm i mirë rritja e

kapacitetit të testimit. “Lajm i mirë është se kapaciteti i testimit do të rritet deri tri herë më shumë se deri tani. Pas angazhimit të vazhdueshëm për shtimin e numrit të pajisjeve për testim, u arrit qëllimi. Tash shtohet edhe

numri i testeve brenda 24 orëve. Këto dy aparatura janë donacion nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Jemi të bekuar me miqësinë e donatorëve. Donacion tepër i çmueshëm në kohë pandemie”, ka thënë Zemaj.

Gjermania ndihmon Kosovën me 15 respiratorë në luftën kundër Covid-19



PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Shteti gjerman, përmes ambasadës së vet në Prishtinë, i ka dorëzuar Qendrës Klinike Universitare 15 respiratorë në vlerë prej 437 mijë eurosh, të cilët janë financuar nga Ministria e Jashtme Federale si ndihmë shtesë dhënë Kosovës në luftën me pandeminë Covid-19.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, vlerësoi lart kontributin e shtetit gjerman gjatë kohës së pandemisë, ndërsa theksoi se aparatura e re do t'i ndihmojë profesionistët shëndetësorë që ta shpëtojnë jetën e atyre të cilët mund të përballen me Covid-19.

Zemaj, po ashtu, bëri me dije se nga sot do të trefishohet numri i testeve për Covid-19. “Sapo erdha nga IKShP. Nga sot do të trefishohen kapacitetet testuese falë ndihmës së donatorëve. Ky

front i përbashkët i krijuar me popullin e civilizuar evropian na e shton përgjegjësinë për angazhim shtesë”, ka thënë Zemaj.

Ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, me këtë rast ka theksuar se shpreson që pajisjet e reja të përdoren sa më pak, pasi do të ishte një tregues i mirë në rrugën për ta fituar luftën me pandeminë.

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, falënderoi shtetin e Gjermanisë për përkrahjen e vazhdueshme. “Ne e sigurojmë Ambasadën e Gjermanisë dhe taksapaguesit gjermanë se pajisjet do të përdoren sipas nevojës, me shumë kujdes. Që të mos kemi nevojë për aparatura të reja, ne, si qytetarë, duhet ta kryejmë punën tonë, duke zbatuar masat për parandalimin e pandemisë Covid-19”, është shprehur Krasniqi.

Pandemia Covid-19 shkakttoi dëme në industrinë e HORECA-s

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 TETOR - Bizneset që operojnë në industrinë HORECA, përkatësisht hotelet, restorantet dhe kafiteritë, kanë qenë dukshëm ndër më të prekurat nga ndikimi i pandemisë Covid-19 dhe vendimet përkatëse për parandalim të përhapjes së saj. Rënia e qarkullimit të të hyrave, si dhe rritja e pasigurisë së konsumatorëve në produktet dhe shërbimet e luksit që ofrohen nga ky sektor, kanë shkaktuar dëme të jashtëzakonshme në këtë industri.

Në forumin virtual të radhës të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, bashkë me përfaqësues të bizneseve që operojnë në këtë industri, u diskutua mbi implikimet që pandemia ka shkaktuar për këto ndërmarrje.

Erëmal Bajrami, menaxher i përgjithshëm në KFC Kosova, njëherësh edhe kryesues i komitetit të gastronomisë dhe turizmit të Odës Amerikane, si dhe moderator i këtij forumi, theksoi se gjatë këtij viti industria e HORECA-s është ndikuar rënd nga izolimi i detyrueshëm i shkaktuar nga pandemia Covid-19, i cili ka

luajtur një rol mjaft të madh në rënien drastike në ekonomi, pasojat e së cilës do të ndihen për vite me radhë.

Shkumbin Muçolli, menaxher i përgjithshëm në “Burger King Kosova”, si dhe anëtar i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, potencoi se muajt e kaluar, respektivisht që nga shpërthimi i pandemisë në muajin mars, janë karakterizuar me rënie të qarkullimit të të hyrave në biznese dhe, fatkeqësisht, humbje të mëdha të vendeve të punës. Duke u ndërlidhur me masat e marra nga qeveria, përfshirë këtu edhe Pakon për Rimëkëmbje Ekonomike e cila ende është në proces të miratimit, Muçolli tha se, megjithëse kjo pako është vonuar, mbetet mjaft e rëndësishme për mbijetesën e bizneseve në vend. Ai potencoi rëndësinë që ka sektori i HORECA-s falë numrit të madh të punëtorëve që punëson, ndikimit në përmirësimin e imazhit të vendit si dhe ndikimit të përgjithshëm si një ndër shtyllat kryesore të ekonomisë, derisa tha se ndalimi i veprimtarive të këtij sektori do ta thellojë tutje krizën që po përjetojmë, rrjedhimisht duke stagnuar zhvillimin ekonomik për vitet e



ardhshme.

Gani Mehmeti, kryeshef ekzekutiv në kompaninë “Nartel”, foli mbi vështirësitë me të cilat hoteli i tij po përballet gjatë kësaj kohe. Ai shprehu pakënaqësinë e tij rreth qasjes së shtetit ndaj sektorit të hotelierisë, ku theksoi se gjatë kësaj periudhe shumë biznese janë të detyruar që t'i largojnë punëtorët nga puna në pamundësi për të ofruar paga për të njëjtët. Sipas tij, një çështje tjetër që duhet adresuar nga qeveria dhe nga publiku në tërësi është mungesa e përfshirjes së përfaqësuesve të sektorëve më me ndikim në ekonominë e Kosovës gjatë draftimit të ligjeve që i afektojnë këta sektorë, pasi që të njëjtët do të mund të ofronin një pasqyrë më reale mbi sfidat dhe

vështirësitë nëpër të cilat po kalojnë dhe rrjedhimisht qasja ndaj problemeve të tyre do të ishte më gjithëpërfshirëse. Bujan Stavileci, menaxher i shitjeve dhe marketingut në hotelin “Four Points by Sheraton Prishtina City”, theksoi se hoteleria si industri gërsheton brenda vetes edhe sektorë të tjerë siç janë gastronomia, argëtimi dhe organizimi i eventeve, prandaj implementimi i masave mbrojtëse kundër pandemisë Covid-19 ka krijuar një sfidë të madhe brenda hotelit “Four Points”, i cili edhe ashtu është hapur në këtë periudhë të krizës. Sipas tij, pandemia ka ndikuar dukshëm edhe në sigurinë e klientëve për shërbimet e luksit që ofrohen nga hoteleria.

Stavileci theks të veçantë u dha disa boshllëqeve në masat e marra nga qeveria, ku tha se të njëjtat do të duhej të personalizoheshin në bazë të specifikave të industrive, në mënyrë që implementimi i tyre të ishte më lehtë i zbatueshëm nga qytetarët që frekuentojnë hotelet në Kosovë dhe bizneset në industrinë e HORECA-s në përgjithësi. Sipas panelit të ftuar në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, qeveria duhet ta rrisë mbështetjen përmes injektimit të fondeve dhe rishikimit të masave të vendosura për këtë sektor, ndërsa kuvendi duhet ta trajtojë me seriozitet Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, meqë çdo vonesë do të thotë humbje për ekonominë e vendit.

Raporti i Progresit njeh reformat e ndërmarra nga BQK-ja

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka mirëpritur përfundimet e nxjerra në raportin e Komisionit Evropian (KE) për Kosovën për vitin 2019, i cili njeh angazhimin dhe reformat e ndërmarra në sektorin financiar dhe ofron rekomandime për avancime të mëtejme.

Raporti thekson progresin që BQK-ja ka bërë në fushën e kërkesave të kapitalit dhe menaxhimit të riskut të bankave pas hyrjes në fuqi të rregulloreve mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe raportin e leverazhit, të cilat janë në linjë me kornizën Basel III. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit konsiderohet i qëndrueshëm dhe mjaft mbi minimumin e kërkuar rregullator prej 12-përqindësh. Sipas njoftimit të BQK-së, në anën tjetër raporti thekson nevojën e themelimit të autoritetit të pavarur të rimëkëmbjes dhe përmbylljes, si dhe amendamentimin e Ligjit të bankave për t'ia përcaktuar këtë mandat Bankës Qendrore dhe për të siguruar pavarësi



funkionale të këtij autoriteti. “Raporti i KE-së vlerëson masat e ndërmarra nga BQK-ja për fuqizimin e transparencës së çmimeve të kreditimit ndaj konsumatorëve. Që nga viti 2019 të gjitha institucionet kreditore duhet ta përdorin formularin standard evropian të informacionit kreditor për konsumatorët për aplikimet për kredi, në mënyrë që të sigurohet shpalosja adekuate e informacionit kreditor”, thuhet në njoftimin e BQK-së. Sipas njoftimit të BQK-së, një

hapësirë të veçantë raporti u kushton zhvillimeve të lidhura me ndikimin e pandemisë në ekonominë e Kosovës, me ç'rast thekson masat e ndërmarra nga ana e BQK-së për t'i ndihmuar huamarrësit për tejkalimin e vështirësive financiare që kanë buruar si pasojë e krizës. Me këtë rast, raporti përshkruan masat rregullatore dhe mbikëqyrëse të BQK-së të cilat kanë mundësuar shtyrjen e pagesave të kësteve të kredisë për huamarrësit si dhe kanë krijuar lehtësira për

ristrukturimin e kredive. “Në fushën e sigurimeve, raporti thekson se BQK-ja ka vazhduar më tutje zbatimin e masave të Solvencës I, duke amandamentuar Rregulloren mbi kalkulimin e minimumit të pragut të solvencës, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe fondit të garantimit për siguruesit jojetë, si dhe duke adoptuar rregulloren mbi likuidimin e siguruesve. Sidoqoftë, raporti po ashtu thekson nevojën për zhvillimin e një udhërrëfyese për zbatimin e masave të Solvencës II. Një fushë tjetër e adresuar në raport ka të bëjë me ndryshimin e Rregullores mbi menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve operative për siguruesit jojetë, me çka është zvogëluar limiti i raportit të shpenzimeve operative ndaj gjithsej kostove nga 35 për qind në 24 për qind. Raporti thekson se Banka Qendrore nuk ka marrë ndonjë masë të menjëhershme për liberalizimin e çmimeve në tregun e sigurimeve. Sidoqoftë, BQK-ja në shtator të këtij viti ka

njoftuar publikun lidhur me përgatitjet e përbashkëta me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për ndryshim të modelit të përcaktimit të çmimit bazuar në rrezik”, bëhet më dije në njoftimin e BQK-së. Mosadresimi i çështjes së automjeteve të pasiguruara dhe paregjistruara, si dhe kostot që i shkaktohen sektorit të sigurimeve, vazhdojnë të theksohen si çështje shqetësuese në këtë raport. Gjithashtu, mungesa e mbulimit të Kosovës me kartonin e gjelbër, sipas raportit, vazhdon të përfaqësojë një barrë financiare për udhëtarët (përveç atyre nga vendet me të cilat Kosova ka marrëveshje bilaterale të sigurimit të automjeteve). Banka Qendrore e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar që ta vazhdojë avancimin e reformave në sistemin financiar me qëllim të forcimit dhe zhvillimit të mëtejme të këtij sektori si dhe plotësimin e kriterëve të nevojshme për avancim në fushën e integritetit evropian.

Vlera e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore arrin në 100.2 milionë euro

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 TETOR - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka mbushur katër vjet nga miratimi i garancive të para kreditore. Ndërtimi i portofolit për këta katër vjet ka arritur vlerën kumulative të kredive të miratuara në 207.3 milionë euro, ndërsa vlera e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka arritur në 100.2 milionë euro të shpërndarë në 5 451 kredi.

Gjatë këtyre katër viteve FKGK-ja ka vazhduar të jetë proaktive ndaj nevojave të sektorit, duke i përmirësuar në vazhdimësi proceset, kriteret kualifikuese, si dhe duke i avancuar produktet e garancisë. Përmes garantimit të kredive, Fondi ka ndikuar në përmirësimin e performancës së NMVM-ve me investimet e bëra nga kreditë e garantuara por, mbi të gjitha, ka ndihmuar zhvillimin e ekonomisë përmes zhvillimit të biznesit, kreativitetit dhe inovacionit. Kur flasim për ekonominë e vendit tonë, në radhë të parë mendojmë për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrje këto me bazament fundamental për rritjen e

më tutjeshme të tregut.

Në komunikatën e FKGK-së thuhet se investimi në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë është i barazvlefshëm me investimin në hapjen e vendeve të reja të punës, në rritje të prodhimit, në teknologji e në inovacion. “Të gjitha këto, të rëndësishme jetike për vendin tonë. Sot kujtojmë edhe bashkëpunimin me bankën e parë përmes së cilës kemi bërë garantimin e kredive të para katër vjet më parë, bankën ProCredit. Si bankë e orientuar drejt zhvillimit dhe gjithnjë në përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme në vend, padyshim se edhe bashkëpunimi me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore vjen natyrisht duke qenë se jemi të hapur për çdo lloj iniciative e cila në epiqendër ka mbështetjen dhe avancimin e bizneseve. Ky bashkëpunim katërvjeçar ka ndihmuar që klientët e bankës ProCredit, respektivisht bizneset e vendit, përmes garancive kreditore të kenë lehtësi shtesë në financimin e planeve të reja investive dhe rritjen e produktivitetit të biznesit”, është thënë në komunikatën e FKGK-së.

Sipas kësaj komunikate, sukseset



dhe rezultatet e arritura nga investimet e klientëve të biznesit në kuadër të FKGK-së thellojnë këtë bashkëpunim edhe më tepër në përkrahje të bizneseve me fokus në sektorin e prodhimit dhe agroindustrinë si dhe investimet e reja të bizneseve me fokus ekonominë e gjelbër, kursimin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. “Bashkëpunimin me FKGK-në e kemi filluar të parët dhe do ta vazhdojmë qëllimin e përbashkët për mbështetje të bizneseve të vogla dhe të

mesme të cilat japin kontribut thelbësor në ekonominë e vendit”, citohet të ketë thënë Eriola Bibolli, drejtoreshë ekzekutive e bankës ProCredit. Në këtë komunikatë theksohet se “kohët e vështira si këto, periudha kur rimëkëmbja ekonomike është kryefjalë e çdo veprimi të më tutjeshëm në ekonomi, roli i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore vetëm sa vjen e potencohet më shumë, si institucioni shtytës dhe mbështetës i zhvillimit ekonomik përmes hapjeve të

mundësive brenda tregut. Këtë e dëshmoi edhe vazhdimësia e FKGK-së në ofrimin e garancive kreditore edhe gjatë këtyre muajve duke ofruar garanci kreditore për 934 NMVM me një vlerë kumulative prej 34.4 milionë eurosh. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mirëpret bashkëpunimet e ardhshme me institucionet financiare në Kosovë dhe me krenari zë vendin e tij si faktor domethënës në zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës”.

Banka Botërore paralajmëron: Varfëria mund të rritet

UASHINGTON, 8 TETOR - Ekonomia e Kosovës gjatë këtij viti pritet të tkurret për 8.8 për qind. Kështu thuhet në raportin e publikuar të mërkurën nga Banka Botërore për ekonominë në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore. “Pandemia Covid-19 ka shkaktuar rënie në eksportin e shërbimeve dhe zvogëlim të investimeve dhe konsumit. Qeveria është përgjigjur shpejt duke siguruar përkrahje për firmat dhe punëtorët,



megjithatë punësimi pritet të ulet ndërsa varfëria të rritet”

thuhet në raport.

Më tutje thuhet se remitencat

në rritje pritet ta zbusin ndikimin e tkurrjes ekonomike. Rimëkëmbja pritet të jetë më e ngadalshme sesa është parashikuar më herët, meqenëse pandemia po zgjat më shumë sesa që pritej, duke penguar kështu rritjen ekonomike në vitin 2021. Ndërkohë në raportin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), të publikuar më 1 tetor, thuhet se ekonomia e Kosovës pritet të tkurret rreth 5 për qind këtë vit si pasojë e

pandemisë me koronavirus, mirëpo vitin e ardhshëm mund të kthehet në binarë me një rritje prej 4 për qindësh. Sipas BERZh-it, arsye për këtë rënie është zvogëlimi i investimeve (9 për qind), sektori i ndërtimit (12 për qind) si dhe ndikimi i pandemisë pothuajse në çdo sektor. Raporti thotë se vlerësimi për rritjen ekonomike mund edhe të duket më i zymtë nëse rastet me Covid-19 rriten dhe ekonomia mund të bllokohet përsëri.

Ministri Kuçi: Ankandi për energji të ripërtërishme po merr formë konkrete

PRISHTINË, 8 TETOR (ER) - Të enjten është mbajtur takimi virtual në mes të ministrit të Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, përfaqësuesve të Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ku temë diskutimi ishte ankandi për energji të ripërtërishme.

Ankandi për energji të ripërtërishme, i cili si ide ka kohë që

është lansuar, do ta zëvendësojë sistemin e tarifës nxitëse për energji të ripërtërishme. Në këtë orientim të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka ndihmuar me një konsulencë të profilizuar për ankand.

Ministri Kuçi ka falënderuar të dyja bankat për ndihmë për këtë ankand, duke e theksuar

angazhimin e sjell një kosto më të përballueshme për konsumatorë dhe që është një hap drejt politikave të gjelbra të ekonomisë dhe energjisë.

Kjo qasje u përshëndet nga shefi i Zyrës së Bankës Botërore, Massimiliano Paolucci, duke e parë si hap pozitiv të Qeverisë së Kosovës. Në këtë takim pati edhe një informim për procedurat e punëve që kanë filluar



nga grupet punuese, për të cilat ministri udhëzoi të punohet me ritëm të shpejtë, që ankandi i

parë për energji të ripërtërishme të zhvillohet në pjesën e parë të vitit 2021.

Certifikohen të rinjtë e Drenasit në fushën e ndërmarrësisë

DRENAS, 8 TETOR (ER) - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) në bashkëpunim me Organizatën ACCESS kanë organizuar të enjten ceremoninë e certifikimit për 30 të rinj të Komunës së Drenasit dhe Vushtrisë në kuadër të programit "Trajtime profesionale për qasjen e të rinjve në tregun e punës", mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Në këtë ceremoni i pranishëm ishte edhe drejtori i Departamentit për Rini në kuadër të MKRS-së, Xhevat Bajrami. Me këtë rast, drejtoresha e DKRS-së, Shqipe Zogu, ka thënë se "i gëzohem

faktit që edhe këtë vit 15 të rinj të komunës sonë përfituan nga ky aktivitet dhe tashmë janë të trajnuar dhe kanë fituar një përgatitje shtesë për tregun e punës dhe shpresoj se edhe më tutje do të vazhdojë dhe të rritet bashkëpunimi me aktorët në fjalë duke krijuar kështu kushte më të mira për të rinjtë tanë". Të rinjtë e certifikuar kanë përfituar në ngritje të kapaciteteve të tyre në fushën e ndërmarrësisë dhe të të bërit biznes përmes teknologjisë informative. Këta të rinj do të kenë mundësi të aplikojnë në MKRS për start-up biznese, duke e rritur kështu mundësinë për punësim dhe mirëqenien e të rinjve.



Nëntë fermerë nga Kamenica përfitojnë sistem të ujitjes

Kamenicë, 8 tetor (ER) - Komuna e Kamenicës, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), së bashku me IADK-në kanë shpërndarë sistemin e ujitjes dhe pajisjet e tjera përcjellëse për nëntë përfitues të serrave. Ky projekt është bashkëfinancim në mes të Komunës së Kamenicës dhe IADK-së.



Kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, duke uruar të rinjtë përfitues të këtij projekti, ka thënë se do të vazhdojë t'i ndihmojë edhe më tutje të gjithë fermerët kamenicas. "Uroj të gjithë përfituesit e këtij projekti i cili është projekt mjaft i mirë për të rinjtë e komunës sonë. Shpresoj dhe besoj se këta të rinj do të arrijnë të zhvillojnë këtë sektor. Komuna e Kamenicës do të vazhdojë t'i

mbështesë të gjithë fermerët sepse komuna jonë ka potencial natyror dhe ujqor për zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, i jam shumë falënderues edhe IADK-së për bashkëpunim", ka thënë Kastrati.

Edhe drejtori i DBPZHR-së, Naim Arifi, ka falënderuar IADK-në për bashkëpunim

dhe fermerëve përfitues u ka uruar punë të mbarë për zhvillimin e këtij sektori në Kamenicë. Një ndër objektivat kryesore të këtij projekti është përkrahja e të rinjve që nuk janë në marrëdhënie pune dhe të cilët janë të gatshëm të inkuadrohen në fushën e bujqësisë.

Lupçi i Poshtëm do të bëhet me urë të re

Podujevë, 8 tetor (ER) - Nënkrjetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka pritur në takim drejtoreshën e Agjencisë Zhvillimore Rajonale - Qendër, Mrika Gashi. Gjatë takimit, ku ishte i pranishëm edhe drejtori i Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi dhe drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Bunjamin Hoti, është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit për realizimin e

projekteve të përbashkëta. Pas takimit, nënkryetari Rudari dhe Gashi kanë vizituar punimet për ndërtimin e urës në fshatin Lupçi i Poshtëm, projekt të cilin po e realizojmë me bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Kjo do të jetë ura më e madhe e ndërtuar mbi lumin Llap në komunën tonë dhe do t'i ketë dy korsi lëvizjesh të automjeteve.



Haziri befasohet për të mirë me arritjet e kompanisë "Fundamenti"

GJILAN, 8 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me nënkryetarin Arbër Ismajli dhe drejtorin e Urbanizmit, Bekim Bajrami, kanë vizituar kompaninë për përpunimin e mermerit dhe granitit, "Fundamenti", së cilës i është ofruar bashkëpunim i plotë. Ai është shprehur të jetë i befasuar me arritjet e kësaj kompanie si dhe me numrin e madh të të punësuarve. "Familja Halili në Gjilan është një prej familjeve që ka dhënë kontribut të madh për qytetin.



Jam befasuar për të mirë me këtë çka pashë këtu, me arritjet, teknologjinë dhe numrin e punëtorëve të 'Fundamentit'. Meqë komuna vazhdon të ndërtojë partneritet me biznesin privat, e sigurojmë 'Fundamentin' se do të jetë pjesë aktive e trekëndëshit të bashkëpunimit mes nesh, donatorëve dhe kësaj kompanie, në mënyrë që të ndikojmë në zhvillim sa më të mirë dhe me standarde", ka thënë Haziri pas vizitës. Kurse pronari i kësaj

kompanie, Bashkim Halili, e ka falënderuar kryetarin Haziri për vizitën, teksa ka njoftuar se kjo kompani ka të punësuar më shumë se 40 punëtorë. "Jemi të nderuar që erdhën sot për vizitë kryetari Haziri e nënkryetari Ismajli. Është hera e parë që na viziton dikush prej institucioneve shtetërore dhe besojmë se në të ardhmen bashkëpunimi do të jetë edhe më i madh në mes të komunës dhe kompanisë sonë. Ne jemi kompani serioze dhe numri i punëtorëve e kalon numrin 40", ka thënë Halili.

Me kë e ka fushatën këtë herë Edi Rama



Shkruan: Bedri ISLAMI

Të gjithë ata që mendojnë se Edi Rama kësaj here e ka betejën me Lulzim Bashën dhe Kryemadhin janë të gënjer. Edhe ata që kanë pasur bindjen se Berisha do t'i përveshë mëngët dhe do të jetë më i pranishëm se kurrë në fushatë, përsëri janë të gabuar. Berisha vetë është në zdërrhalljet e tij politike, që nuk janë asgjë tjetër veçse ripërsëritje e një lajtmotivi të njohur, por që tani nuk ka as forcën, as mbështetjen dhe as të panjohurën e duhur në politikë. Edhe në listën e deputetëve të opozitës ai do të futet me forcë, përmes tri përbuzjeve dërrmuese: të Lulzim Bashës - Berisha mund të kandidojë ku të dojë, që do të thotë është njëllor për ne; të ish-ministrit të Ekonomisë Ruli, i cili i bëri thirrje haptas të largohet sa nuk e kanë larguar dhe, në fund, Mustafaj - loajal ndaj rolit institucional që, duke e mbrojtur si të domosdoshëm, në fakt, në mendimin politik i dha shtysën. Berisha këtë herë do të jetë lojtari rezervë, do ta ndjekë nga stoli dhe kur të futet në lojë, do të prishë punë.

Tjetërkush ka vendosur të jetë njeriu që ka marrë përsipër ta përballojë Ramën dhe këtë, me gjithë postin e tij, shpeshherë honorifik, ai po shfaqet haptas, duke lënë në hije gjithë të tjerët. Në secilën ditë të vitit ai shpall kredon e tij për rrëzimin e qeverisë dhe këtë tashmë nuk e fsheh në asnjë çast, i gatshëm të marrë mbi vete gjithçka mbi rolin që i takon.

Treni i votuesve të opozitës mund ta kenë vënë në fillesë portretin e Bashës por, në fakt, makinisti është një tjetër. Ai quhet Ilir Meta dhe është de jure presidenti i Republikës, i zgjedhur, thaj përdhunshëm në këtë post nga e majta, që sot është mëria e tij më e madhe dhe, de fakto, shefi real i opozitës në të gjitha përmasat e saj.

Të gjitha çfarë kanë ndodhur deri tani do të duken si lojëra fëmijësh ndaj asaj që ka vendosur të përballojë dhe, edhe nëse nuk do të ketë përsëri një miting alla 2 mars, ku sheshin e mbushën pasuesit e Bashës, që menduan se ajo ishte dita e fundit e parlamentit, por flamurin e mori presidenti që, si asnjëherë tjetër, vendosi të ecë

përmes dy rrugëve: ose të bëjë harakiri politik dhe e bëri, ose të trajtojë të gjithë këtë si betejën finale. Dhe ai e ka konceptuar si betejë e jetës së tij. Pas saj ai, ose do të jetë një askush, ose do të jetë njeriu që i ka mundur të gjithë: Nanon, mentorin e tij në vitin 2005, kur e rrëzoi nga pushteti që edhe ai vetë donte të binte, i lodhur sa më nuk ka; Ramën në zgjedhjet bashkiake, kur u vendos në krah të Bashës, duke e ditur se ky nuk do të mund të ishte kurrë rivali i tij politik; dhe së fundi edhe Berishën në zgjedhjet e vitit 2013, kur papritmas u bë njësh me Ramën nxori shpatën nga milli, kërcënoi furishëm dhe kapi rishtas pushtetin.

Për shumë vite, më saktë deri në vitin 2017, ai ishte njeriu i tretë i domosdoshëm i qeverisjes, kandari i së cilës rëndonte nga shkonte vetë ai, ashtu i shëndoshë si ishte, peshë e rëndë dhe muskuloze në politikë.

Me humbjen e peshës duket se humbi edhe fuqia e tij politike. Viti 2017 e gjeti atë në një gjendje nokdauni, kur do të ndodhte edhe rënia e parë e ndjeshme e forcës së tij. I vetëdijshëm se humbja do ta sillte katastrofën, ai hoqi kostumin presidencial, të porsa qepur, rimori rrobat e njohura të LSI-së, nxori rishtas nga "tavanët e vjetër hutat e tij", dhe si nuk kishte ndodhur vetëm në kohën e Berishës së parë, kërcënoi me luftë.

Mes Ramës dhe Metës ka një histori të vjetër dashuri - urrejtjeje, për të kaluar më pas në urrejtje - dashuri, duke shkaktuar tajfunë politikë kur

kanë qenë së bashku, dhe batica-zbatica gazmore kur ua ka marrë mendja se bëjnë pa njëri-tjetrin.

Të bashkuar për të mundur Nanon, herë pas here i janë kthyer përkëdheljes së tij, si ndaj një të keqeje të domosdoshme që, edhe ashtu, si i përgjumur, mund t'i zgjonte dreqërit e vjetër të një lëvizjeje politike besnike ndaj shefit dhe të qetë të ditën e votimit. Duke mundur Nanon që, në fakt, cinik siç është, e merrte të gjithë këtë agresivitet me sportivitet, e në të njëjtën kohë duke marrë me vete edhe haraçin e mundjes së tij, ata, të dy, e dinin se një ditë do të përballeshin ashpër. Shqipëria ishte e vogël për dy njerëz që nuk e dinin të qenit jashtë politikës dhe ku ishin rastësisht bashkë, pas një fillese të kundërt. Rama po bëhej shefi i të majtëve, duke qenë fillimisht i gjithi i ekstremit të djathtë, "dashuri" që ende nuk e ka harruar; Meta po kalonte në prehrin e asaj që quhej e djathtë, kur pikërisht nga ajo do të ishte deputeti i parë të cilit i kërkohet heqja e imunitetit.

Rama e llogarit me kujdes edhe sot e kësaj dite goditjen nën brez të Metës. Meta e ka parashikuar momentin dhe vendin ku mund ta godasë "i gjati". Një histori e tillë, "me zemra të këputura" dhe "lidhje dashurie ngjalore", që pak ose aspak ka të bëjë me dinjitetin, është në të shumtën e rasteve përlllogaritje pushteti dhe mbijetese.

Rama e di se humbja e tij do të thotë në një mënyrë ose një tjetër edhe fundi i jetës së tij politike drejtuese dhe roli i tij si shefi i madh brenda së majtës do të jetë drejt fundit. Ai e ka

llogaritur këtë, por jo gjithnjë hesapet e shtëpisë të dalin në pazar.

Meta e di, po ashtu, se një fitore e Ramës në mandatin e tretë, më shumë sesa humbje e Bashës, do të jetë humbja e tij. Basha mund të humbasë dhe të largohet pa lënë gjurmën e tij në historinë e PD-së, por kjo nuk do të thotë se të gjitha meritë, mallkimet e shëmtitë do të bien mbi të. Ndoshta, duke u nisur nga kjo pasvijë, ai po e lë topin e politikës më së shumti në këmbët e Ilir Metës, duke e ditur se, në nëse fitohen zgjedhjet, ai do të jetë shefi i qeverisë dhe, nëse humbasin, ai nuk do të jetë i mallkuari i madh.

Mandati i tretë i Ramës është çmitizimi përfundimtar i LSI-së si peshë e mesit të artë. Ajo do të kthehet në një peshë pupël dhe këtë e di shefi i presidencës. Pas saj mund të ndodhin disa gjëra të frikshme për të, por të mirëpritura për njerëzit. Mund të nisë shkallmimi i politikës së vilave, që do të niste nga Lalzi, vendi i politikës mjerane, i drejtësisë mizerje dhe i korrupsionit fatal, për të shkuar drejt një goditjeje që askush sot nuk e mendon.

Jo më kot, institucione të rëndësishme ndërkombëtare, më së shumti evropiane, po këmbëngulin që të nisë goditja e peshqve të mëdhenj dhe gjithkush e di fare mirë se është vështirë të nisë shturja e pëlhurës, pastaj gjithçka rrjedh vetë. Dosjet e dërguara në SPAK jo vetëm nga institucione vendore do të përbëjnë jo shumë larg gjithë barrën e këtij institucioni. Marrëveshja e fundit mes Kontrollit të Lartë të

Shtetit dhe Institucioneve të Drejtësisë, për çka ka pasur këmbëngulje të hershme edhe nga ish-kryetari i KLSH-së, Bujar Leskaj, është, po ashtu, një tabu që po shembet.

Në vëzhgimin e këtyre institucioneve është pikërisht ky dualitet, mes shefit të presidencës dhe shefit të qeverisë, më shumë se sa ndërmjet shumicës dhe opozitës jashtëparlamentare, se vetëm përmes këtij dualiteti mund të krijohen përplasje të ndjeshme, pasi gjërat që janë vënë në lojë janë të mëdha dhe të rrezikshme.

Si duket, më mirë se të tjerët, Ilir Meta nuk e ka besimin pikërisht te Basha si lider i opozitës dhe si njeri, pasi, po aq sa ka peshë të rëndë në këmbë politikën cinike dhe qesëndisëse të Ramës, po aq ka edhe politikën heshtëse të Bashës. Atij i rëndon mospërfillja e tashme e Ramës, por edhe e sëmbon heshtja e Bashës. Ndërsa të parin e njëh më mirë dhe e di se goditja mund t'i vijë në secilin çast ku nuk e ka pritur, për të dytin e papritura mund të jetë me pasoja më të mëdha, si listë e veçantë e opozitës, pa përfshirë në të listën e LSI-së, që ka fituar disa herë deputetë nga tepricat e trenit të opozitës, partive të vogla etj., por edhe drojën se mos, nën ndikimin evropian, dy forcat e mëdha politike bëjnë një koalicion të madh, të përkohshëm, katërvjeçar, ku ai do të mbetet në zallin e politikës. Përplasjet kanë nisur më herët se zakonisht dhe llogaritjet po bëhen më të shpeshta.

Do të kemi një dimër përvëlues dhe një pranverë dimri para vetes.



DISA FAKTE RRETH ÇMIMIT ‘NOBEL’

Në muajin tetor, Akademia Suedeze u ndan çmimet “Nobel” personaliteteve botërorë të cilët, me veprën, kërkimin apo zbulimin e tyre lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e disiplinës ku vlerësohen. Këto çmime ndahen për kategoritë: fizikë, kimi, mjekësi, letërsi, paqe dhe shkenca ekonomike. Që prej themelimit nga Alfred Nobel në vitin 1895, janë dhënë gjithsej 597 çmime, 112 prej të cilëve në letërsi.

Përgjatë viteve, “Nobel” për letërsinë nuk është dhënë më 1914, 1918, 1935, 1940, 1941, 1942, 1943. Sigurisht, mbajmë


mend edhe vitin 2018, por “Nobel” i atij viti nuk u anulua, ama u nda vitin passardhës, laureate e të cilit ishte Olga Tokarczuk.

Laureati më i ri i një “Nobel”-i në letërsi është Rodyard Kipling në vitin 1907 kur ishte vetëm 41 vjeç, ndërsa më e vjetra, Doris Lessing e cila në 2007 kur mori “Nobel” ishte 88 vjeçe. Në tërësi, më e reja që ka fituar një “Nobel” është Malala Yousafzai e cila ishte vetëm 17 vjeç kur mori “Nobel”-in për Paqe. Më i moshuari, John B. Goodenough që në 2019, në moshën 97 vjeçare, mori “Nobel” në Kimi.


Në vitin 1958, shkrimtari Boris Pasternak fitoi këtë çmim, por u detyrua nga Bashkimi Sovjetik (vendlindja e tij) të mos e pranonte, ndërsa më 1964, Jean-Paul Sartre refuzoi çmimin që ju dha në letërsi, pasi gjatë jetës kishte refuzuar çdo nderim zyrtar.

Mes 57 grave që kane fituar “Nobel”, 15 janë laureate të këtij çmimi në fushën e letërsisë, që nga Selma Ottilia Lovisa Lagerlöf (1909), deri te Olga Tokarczuk (2018).

Sivjet do të jetë data 8 tetor ajo në të cilën, në orën 13:00, të gjithë do të mësojmë fituesin e “Nobel”-it në letërsi për vitin 2020.



NGA AGJENCITË E LAJMEVE, TE KOMPANITË E BASTEVE: KUSH JANË FAVORITËT E ÇMIMIT NOBEL?



Përshëndetje! Mirë se erdhët në sezonin e spekulimeve për Çmimin “Nobel”, një kohë argëtimi kur të gjithë lundrojnë në mbretërinë e letrave... Kështu fillon shkrimi rreth “Nobel” i Jonny Diamond për “LitHub”. Duke vijuar më tej, ai shtron pyetjen Kështu, çfarë mund të na ketë rezervuar Nobeli i sivjetshëm në letërsi? Le të provojmë t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje duke u bazuar në disa parashikime të bëra nga

agjenci ndërkombëtare, por edhe kompani bastesh. Sipas Agence-France Presse, kandidatë të mundshëm për të fituar “Nobel”-in e sivjetshëm janë Ngugi wa Thiong’o, Joyce Carol Oates, Marilynne Robinson, David Grossman, Margaret Atwood dhe Michel Houellebecq. Jo pa ironi, për nomiminim e Houellebecq, Diamond thotë: I dashur komiteti i Nobel-it, ju lutem mos ia jepni [çmimin]

Houellebecq që të paktën mos të shpenzojmë tre ditë në Twitter në një tjetër luftë “letrash të hapura”. Ashtu sikurse vitet e fundit, edhe sivjet në listën e favoritëve është Atwood, autorja kanadeze e “Rrëfenja e shërbëtores”. Por sikurse dihet, “Nobel” e mban sekret listën e ngushtë të kandidatëve për këtë çmim. Kjo bën të ndizen bastet duke kuotuar shkrimtarët më të njohur.

Kompania Nicerodds, në vend të parë me kuotën më të ulët vendos Maryse Conde, duke vijuar me Lyudmila Ulitskaya dhe Haruki Murakami që është në të njëjtin nivel me Margaret Atwood. Ndërsa në fund, me kuotën më të lartë, renditen Houellebecq, Kundera, Stephen King dhe Richaard Osman. Gjithsesi, duket sikur sivjet, kritikët kanë hequr dorë nga propozimet e mundshme për fituesit e këtij çmimi, pasi

“Nobel” ja ka dalë të befsojë herë pas here. Rasti i fundit është ai i Peter Handke, laureat i vitit 2019, polemikat për të cilin vijojnë akoma. Nuk duhet harruar as laureati i 2017, kantautori Bob Dylan. Ky i fundit, as nuk u paraqit në ceremoni për të tërhequr çmimin. Prandaj, të gjithë duhet të presim të enjten e kësaj jave, ditë kur në orën 13:00 do të mësojmë edhe fituesin e çmimit më prestigjioz në fushën e letrave.

DISKUTIMET DHE KONTROVERSAT MË TË MËDHA PËR NOBELIN E LETËRSISË



Kur në fillim të shekullit që lamë pas, u tha se do të jepej një çmim prestigjioz në letërsi, të gjithë i hodhën sytë te shkrimtarët më të njohur të kohës. Prandaj, Leo Tolstoy, Henrik Ibsen, Emile Zola dhe Mark Twain, a më mirë të themi lexuesit e tyre, prisnin nga viti në vit njërin prej tyre si laureat. Por, kjo nuk ndodhi...

Shumë shkrimtarë të mëdhenj nuk e fituan çmimin, pasi Komiteti i Nobelit shprehet se ndjek vullnetin e themeluesit të çmimit, Alfred Nobel, sipas të cilit, autori fitues duhet të ketë shkruar një vepër me “drejtim ideal”.

Sikurse dihet, asnjëri nga shkrimtarët e lartpërmendur nuk e ruajti parimin idealist si boshit nëpër të cilin solli ndodhitë e krijimtarisë së tij.

Duke kaluar vitet, pritshmëritë ndiqnin shkrimtarë të tjerë.

Mes tyre, rasti i argjentinasi Jorge Luis Borges u bë më së tepërmi i njohur, pasi për dekada të tëra u përfol si fitues i mundshëm. Në dialogun mes tij dhe Sabatos, përkthyer në shqip nga Orjela Stefani dhe botuar nga “OM”, është një pjesë interesante që lidhet me këtë temë:

SABATO: A do t’ju bëhej qejfi nëse do ta merrnit çmimin Nobel?

BORHES: Po, do të më vinte shumë mirë. Sepse, do ta humbja vendin si “kandidat i ardhshëm” që e mbaj prej disa vjetësh (qeshje). Pastaj janë edhe paratë. Ka katër ose pesë muaj që nuk e marr pensionin e profesorit të letërsisë angleze në fakultet, sepse nuk kam shkruar për të konfirmuar se jam pensionist. Kjo duket si shaka, por në zyra më thanë se “derisa të konfirmohet kjo e

dhënë, as nuk duhet të shqetësohem dhe as t’i shqetësoj”.

Por, përveç emrave të përveçëm, diskutim ka ngjallur edhe fakti se shumica e laureatëve të këtij çmimi vijnë të jenë evropianët. Në një dalje të vitit 2008, Horace Engdahl, atëherë sekretar i përhershëm i Akademisë Suedeze, thotë se Evropa mbetet qendra e botës së letërsisë. Vetëm laureatë suedezë janë më tepër se të gjithë laureatët aziatikë të marrë së bashku.

Në vitin 1974, kur të gjithë mendonin se fituesi i Nobelit do të zgjedhej mes autorëve Graham Greene, Vladimir Nabokov dhe Saul Bellow, ndodhi diçka e papritur. Çmimi u nda mes shkrimtarëve Eyvind Johnson dhe Harry Martinson, dy suedezë të panjohur jashtë Suedisë dhe jo shumë të njohur edhe brenda saj. Pas dy vitesh,

laureat ishte Bellow, ndërsa Nabokov dhe Greene nuk e morën asnjëherë Nobelin.

Sipas gazetës Times, kur më 1997 Nobel in e mori Dario Fo, kandidatët më favoritë ishin Salman Rushdie dhe Arthur Miller. Por, në momentin e fundit, njëri nga anëtarët e jurisë tha se ata ishin “shumë popullorë dhe të parashikueshëm”. Ishte viti 2004 ai në të cilin anëtar i Akademisë Suedeze, Knut Ahnlund, dha dorëheqjen pasi, sipas tij, laureatja Elfriede Jelinek kishte shkaktuar një “dëm të pariparueshëm” për reputacionin e çmimit.

Për tre vite, 2005, 2006 dhe 2007, Akademia Suedeze u akuzua se po e jepte çmimin “për arsye politike”. Laureatë të këtyre viteve ishin Harold Pinter, Orhan Pamuk dhe Doris Lessing.

Mario Vargas Llosa, laureati i

vitit 2010 u akuzua se më tepër shkruante për politikë sesa letërsi, ndaj edhe Akademia Suedeze mori një sërë kritikash për zgjedhjen e saj.

Dy rastet më të përfolur të viteve të fundit janë ai i Bob Dylanit dhe Peter Handkes. Dylan u bë i pari kantautor që merr një Nobel për Letërsi, ndërsa Handkes iu përmend fakti se i kishte dhënë publikisht mbështetje Millosheviqit (njëjtë si Pinteri).

Nuk është vetëm Nobeli për Letërsi ai që ngjall debate. Edhe për paqen, mjekësinë apo ekonominë ka diskutime, por letërsia që në themel ka lirinë, gjykohet me vështirësi, aq më tepër kur bëhet fjalë për autorët më të mëdhenj të botës. Ndaj kushdo qoftë fitues, pakënaqësi do të ketë mes lexuesve, kritikëve dhe adhuruesve të letrave. /Gazeta “ExLibris”/

Veshjet tradicionale të nuseve arbëreshe

Dy arbëreshe Alessandra Stratigo dhe Rachele Domestico në një video të titulluar “Ori Arbëreshë” (Stoli Arbëreshe) demonstrojnë etapën e veshjes së kostumit të nuses në komunën e Lungro-s. Ky material filmik është realizuar nën përkujdesjen e komunës së San Basiles, në kuadër të aktiviteteve për ruajtjen dhe teçimin e pasurisë së trashëguar ndër brezat tek

pakica etnike shqiptare e kësaj zone.

Gjatë veshjes së modeles-nuse, shpjegohen edhe përbërjet e copave dhe emërtimet e pjesëve të veshjes që ajo mbart. Në video Alessandra dhe Rachele tregojnë një nga pjesët e kostumit tradicional.

“Në fillim vishet një këmishë, e cila zakonisht lihej e lirshme që të përshtatej lehtë. Këmisha ka një jakë të qëndisur dhe të


ngjirë në mënyrë që të qëndrojë bukur. Në pjesën e kraharorit vendoset një centro e qendrisur bukur dhe me kujdes. Mbi këmishë vishe pjesa e parë e funstanit në ngjyrë të kuqe me pjesën e fundit të qëndisur me fije ari, dhe mbi të vishet një tjetër me ngjyrë blu e vila mblidhet si formë brezi duke e lënë pjesën e qendrisur me fije ari si bisht. Sipër vishet xhaketa e shkurtër e gjitha e



qëndisur me fije ari. Mjaft të rëndësishëm janë edhe aksesorët e qafës dhe kokës të punuar me element qëndisje dhe ari”.

Në videon e postuar më poshtë

mund të shijoni gjuhën e bukur arbëreshe të shprehur nga të dyja protagonistet, bazuar në tekstin e Daniele Farai-t.



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Përfundoi ëndrra e Kosovës për kualifikim në Kampionatin Evropian

“Normalisht, është vështirë të gjej fjalët, pas kësaj loje. Për mua do të ishte më mirë të mos shënoja gol, por që të fitonim. Ne ishim të përgatitur veç për fitore e të shkonim në finale, të kënaqim popullin tonë. Vështirë të gjejmë fjalët. Duhet të shikojmë, të flasim me veten e për të kaluar këtë fazë të vështirë për ne”, ka thënë Florent Hadergjonaj



“Epoka e re”

Shkup, 8 tetor - Ëndrra e madhe për kualifikimin historik në Kampionatin Evropian ka përfunduar për Përfaqësuesen e Kosovës në futboll, pasi të enjten në mbrëmje është mposhtur nga Maqedonia e Veriut (2-1). “Normalisht, është vështirë të gjej fjalët, pas kësaj loje. Për mua do të ishte më mirë të mos shënoja gol, por që të fitonim. Ne ishim të përgatitur veç për fitore e të shkonim në finale, të kënaqim popullin tonë. Vështirë të gjejmë fjalët. Duhet të shikojmë, të flasim me veten e për të kaluar këtë fazë të vështirë për ne”, ka thënë pas ndeshjes Florent Hadergjonaj. Kosova është paraqitur mirë në këtë ndeshje,

ani pse në formacioni e saj kanë munguar lojtarët kryesor si Milot Rashica, Vedat Muriqi dhe Amir Rrahmani, por në fund “dardanët” është dashur të pajtohen me eliminim. Në pjesën e parë, Maqedonia kaloi e para në epërsi kur Kololli e devijoi topin që përfundoi në portën e Muriq. Një gabim të portierit maqedonas e shfrytëzoi Florent Hadergjonaj, i cili me një gol të bukur i riktheu në lojë “dardanët”, duke e barazuar rezultatin 1-1. Katër minuta me vonë, Maqedonia e riktheu epërsinë me golin e shënuar nga Darko Velkovski. Në pjesën e dytë Kosova pati me shumë dominim të ndeshjes, por Arbër Zeneli goditi mbi portën kundërshtare, derisa në minutat shtesë Fidan Aliti gjuajti, por

portieri Dimitrevski ndali gjuajtën e mbrojtësit të Kosovës. Në anën tjetër gjuajtjet e Pandevit dhe Alioskit dhe ndeshja përfundoi me rezultat 2-1. Në finale Maqedonia do të përballet muajin nëntor me Gjeorgjinë. Kjo e fundit të enjten e mposhti Bjellorusinë me rezultat 1-0. Mesfushori i Maqedonisë së Veriut, Enis Bardhi ka deklaruar pas ndeshjes se ai do të ndihet mirë edhe po që se do të fitonte Kosova “Normalisht, këto lloj ndeshje janë shumë të rënda si psikikisht dhe fizikisht”, ka thënë fillimisht Bardhi. “Normalisht, e ceka me lojtarët. Futbollit është respekt. Nëse kishte fituar Kosova isha ndier mirë dhe do të isha gëzuar. Në fund të fundit, jemi të njëjtë”, ka shtuar Bardhi.

SHKURT

Dallku emërohet trajner i Dukagjinit

Skuadra e Dukagjinit e ka zyrtarizuar sot si kryetrajner të skuadrës, Armend Dallkun. Pas largimit të trajnerit klinas, Severin Elezaj, Dukagjini ka arritur marrëveshje me ish-trajnerin e Prishtinës. Dallku do e drejtojë Dukagjinin deri në fund të këtij sezoni. Pjesë e shtabit teknik do të jetë edhe ish ndihmësi i tij, Artan Luzi. “Dallku merr timonin e skuadrës së Dukagjinit. Pas largimit të trajnerit klinas Severin Elezaj, klubi tashmë ka arritur akordin me ish-trajnerin e FC Prishtinës, Armend Dallku i cili do ta drejtojë skuadrën tonë deri në fund të këtij sezoni. Pjesë e shtabit teknik të Dallku do të jetë edhe ish trajneri kondicional të FC Prishtina, Artan Luzi. Klubi u dëshiron mirëseardhje dhe suksese në sfidat e përbashkëta. Na priftë e mbara”, thuhet në njoftimin e skuadrës nga Klina.

Shaqiri grumbullohet me Zvicrën, pasi rezultoi negativ në testin për Covid-19

Xherdan Shaqiri rezultoi pozitiv me COVID-19 pak ditë më parë dhe nuk luajti në sfidën e Zvicrës kundër Kroacisë, të cilën “Helvetët” e humbën me rezultatin 1-2. Por të enjten, Federata Zvicerane e Futbollit, ka treguar rezultatin e testit të dytë të sulmuesit të Liverpool, i cili ka rezultuar negativ. Si pasojë, Xherdan Shaqiri do të grumbullohet me Zvicrën. 28-vjeçari do të udhëtojë me kombëtaren e tij drejt Spanjës, për sfidën e radhës. UEFA ka dhënë dritën jeshile për grumbullimin e Shaqirit.

Amadi Ikpeze përforcon KB Rahoveci

Amadi Ikpeze është basketbollisti më i ri që është transferuar nga skuadra e Rahovecit. Lajmin e ka konfirmuar KB Rahoveci përmes një postimi në faqen zyrtare në “Facebook”. “Po kompletohem me hapa të sigurt dhe nënshkrimi me lojtarin tonë të ri, Amadi Ikpeze, vetëm sa e konfirmon këtë fakt. Amadi Ikpeze është vetëm 22 vjeçar, lojtar mjaft i talentuar që luajti në Pozitën e Qendrës (C) për ekipin St. Bonaventure në kampionatin amerikan të kolegjeve. Ai pritet të jetë së shpejti në dispozicionin e kryetrajnerit, Bujar Loci”, thuhet në njoftim e KB Rahoveci.


Rexha: Presim një sezon të suksesshëm

Skuadrat e basketbollit kanë filluar përgatitjet për edicionin e ri dhe mezi po e presin fillimin e edicionit të ri në basketbollin e Kosovës. Turneu i Superkupës do të fillojë më 21 tetor, derisa garat në elitë do të fillojnë më 28 tetor. Një nga skuadrat më të dalluara edicionin e kaluar ishte Rahoveci. “Skuadra e Rahovecit

ka filluar përgatitjet për edicionin e ri para 10 dite. Edhe pse vonë, por besoj se do të ngritemi, si në aspektin fizik dhe atë taktik, si fazë fillestare pasi që dihet se, pandemia na ka ndarë nga palestra nga muaji mars. Shpresojmë që në ditët në vijim ekipi do të kompletohet me ardhjen e lojtarëve të rinj

amerikanë Isaiah Traylor dhe Marvin Jones”, ka thënë kapiteni i Rahovecit, Bardh Rexha për faqen zyrtare të FBK-së. “Për momentin si skuadër jemi të motivuar për edicionin e ri dhe presim që në vazhdim të punojmë sa më shumë me trajnerin Bujar Loci dhe të shfaqim lojëra më të mira, si në

Superligën e Kosovës po ashtu edhe në Ligen Unike. Sa i përket synimeve të Rahovecit janë që të arrijmë sa më lartë në tabelë, sepse ne kemi lojtarë të mirë vendorë, ku edhe presim përforcimet të na ndihmojnë të arrijmë majat e basketbollit të Kosovës dhe asaj Unike”, ka shtuar Rexha.



Curry: Golden State do të jetë i frikshëm sezonin e ri

SAN FRANCISCO, 8 TETOR - Skuadra e Golden State Warriors do të rikthehet të konkurrojë në nivelet e dikurshme sezonin e ri të NBA-së. Është ky premtimi i bërë nga kapiteni dhe lideri i skuadrës, Stephen Curry. Ai ka vlerësuar punën e bërë nga NBA dhe komisionari Adam Silver

që në pak muaj bëri të mundur përfundimin e një sezoni që dukej i humbur si pasojë e pandemisë Covid-19. “Mjafton të mendosh rreth përgatitjeve që ka bërë, për të sjellë në Orlando 22 skuadra, duke nisur gjithçka nga zero. Gjithçka funksionoi për mrekulli. Ia kam thënë

këtë gjë personalisht Adam Silver, një rezultat befasues”, ka thënë Curry. Duke folur për zgjedhjen e ardhshme në draft, ai ka deklaruar: “Kemi nevojë për talente, kjo është ajo që kërkon nga drafti. Mendoj se një lojtar shtatlartë na bën punë, por objektivi është ta kompletojmë

skuadrën. Më pëlqen pozicioni ku ndodhemi, kemi një ekip të mirë, lojtarë që po rikuperohen nga dëmtimet. Sezioni i ri do të jetë i fortë, sidomos në Perëndim. E pamë të gjithë edhe në këtë grumbullim të ekipeve në Orlando se Perëndimi është shumë kompetitiv. Ne do të



jemi mes ekipeve pretendente. Mezi pres të rikthehemi në parket”, u shpreh Curry.

Abrashi pret 6 pikë në dy ndeshjet e radhës

TIRANË, 8 TETOR - Amir Abrashi ishte një nga të përzgjedhurit e stafit mediatik të kombëtares shqiptare për të dalë në konferencën për shtyp. Mesfushori i Freiburgut në Bundesligë erdhi me një dëmtim të lehtë, por konfirmoi se është rikuperuar plotësisht dhe është gati për ta dhënë maksimumin në dy sfidat ndaj Kazakistanit dhe Lituanisë në Ligën e Kombeve. Ai kishte edhe një dëshirë për ndeshjen e Kosovës. “Për momentin jam shumë mirë dhe nuk kam asnjë problem. Jam gati për të luajtur dhe për të dhënë 100 % në fushën e lojës. E di që kam shumë ndeshje dhe dua ta ndihmoj ekipin me përvojën time. Duhet të bëjmë gjithçka për ta përforcuar grupin”, ka thënë Abrashi. I pyetur si ndihet me rreshtimin 3-5-2, Abrashi: “Skemat i kam pranuar gjithmonë dhe përshatam me atë që më kërkohet në



fushë. Na i thotë trajneri çfarë të përmirësojmë dhe si duhet të sillemi, ndaj ne thjesht duhet të jemi të vëmendshëm. Gjithsesi e rëndësishme është që grupi të funksionojë mirë dhe inshallah të marrim tre pikë me Kazakistanin”. Mesfushori Amir Abrashi është i bindur se kuqezinjtë mund të

marrin gjashtë pikë në dy ndeshjet e radhës. “Atë humbje me Lituaninë po e vuajmë akoma, si unë, por besoj edhe lojtarët e tjerë. Megjithatë, të fitojmë tani ndaj Kazakistanit dhe të mendojmë për Lituaninë, ku do të më pëlqente që t’ua kthenim reston shpejt”, ka thënë Abrashi.

Berisha: Shpresojmë ta sigurojmë kualifikimin në ndeshjen e parë

ISTOG, 8 TETOR - Istogu ka zhvilluar fazë të suksesshme përgatitore për edicionin e ri. Istogaset ndeshjen e parë e luajnë të shtunën në Samadrexhë ndaj Vushtrrisë në kuadër të raundit të dytë të Kupës Evropiane. Ndeshja e kthimit luhet në Istog pas një jave dhe kjo motivon skuadrën e Faruk Shalës. Palestra në Istog do të promovohet me ndeshjen ndaj Vushtrrisë. Por aktualisht fokusi i lojtareve të Istogut është te ndeshja e parë. “Stërvitjet janë duke u zhvilluar mjaft mirë. Të gjitha lojtaret jemi në formën më të mirë të mundshme, kurse shpresoj se kjo do të vazhdojë. Më e rëndësishmja është të mos kemi lëndime”, ka thënë Berisha, lojtarja me perspektivë e Istogut. 18-vjeçarja ka konfirmuar se synimet e Istogut janë për të kaluar në raundin tjetër. “Këtë vit jemi më të përgatitura dhe më të forta. Kundërshtarin e kemi të fortë, jemi skuadra rivale,



megjithatë ne jemi shumë të motivuara, pasi ndeshjen kthyesë e luajmë në Istog. Kjo na jep më shumë forcë e siguri. Për herë të parë luajmë në Istog. Është historike për ne. Por, ne synojmë që në Vushtrri

ta kryejmë punën e kualifikimit tutje dhe të vazhdojmë me ambiciet tona në Evropë. Për ta arritur qëllimin do të japim çdo gjë nga vetja që ta bëjmë të lumtur gjithë qytetin e Istogut”, ka deklaruar Berisha.

SHKURT

Shkon në katër numri i të infektuarave me Covid tek Interi

Ka shkuar në katër numri i të prekurve me koronavirus tek Interi. Pas Bastonit dhe Shkrinjarit, të enjten janë konfirmuar edhe dy futbollistë të tjerë të prekur. Bëhet fjalë për mesfushorët Roberto Galjardini dhe Raxha Naingolan. Lajmi është bërë publik nga “Gazzetta dello Sport”, teksa pritet konfirmimi nga klubi zikaltër. Kujtojmë se Interi do të përballet më 17 tetor me Milanin, në derbin e Madoninës. Një situatë kaotike kjo, teksa në rast se rastet vijnë në rritje në ditët në vijim, mund të vihet në rrezik edhe zhvillimi i derbit.

Zbulohet si e dërgoi Reali Costan në Bayern

Mbrojtësi i Real Madridit, Marcelo, u kërkua me ngulm nga Juventusit në këtë afat kalimtar. “Bardhezinjtë”, përveç afrimit të Federico Chiesa, kishin në plan dhe brazilianin, por ishin madrilënët ata që refuzuan marrëveshjen. “Zonja e Vjetër” propozoi një shkëmbim mes Marcelos dhe Douglas Costas, por drejtuesit spanjollë nuk e pranuan diçka të tillë. Sipas raportimit të “AS”, Juventusit bëri maksimumin për afrimin e tij, por marrëveshja nuk u finalizua. Më pas, me afrimin e Chiesës, Douglas Costa duhej të largohej. Sulmuesi anësor kaloi në huazim në radhët e Bayern Munchenit, duke finalizuar kështu merkaton e Juventusit.

Atalanta ndeshjet e Ligës së Kampionëve i zhvillon në Bergamo

Atalantës edhe zyrtarisht i është dhënë e drejta të luajë në Bergamo në ndeshjet e Ligës së Kampionëve si vendës kundër Ajaxit, Liverpoolit dhe Midtjyllandit. Që kur Atalanta filloi të ngjitej në Serinë A dhe të marrë pjesë në garat evropiane, ndeshjet si vendas i ka luajtur në stadione të tjera. Ata kanë përdorur stadiumin ‘Mapei’ më parë, ndërsa sezonin e kaluar stadiumin ‘San Siro’, të Interit dhe Milanit. Stadiumi i Atalantës ka qenë në ristrukturim gjatë vitit të kaluar dhe tani i është dhëna leja për t’i pritur ndeshjet e Ligës së Kampionëve. Atalanta konfirmon se ndeshja e parë e Grupit D ndaj Ajaxit do të luhet në stadiumin e tyre, duke u ndjekur nga Liverpooli më 3 nëntor. Ndeshja e fundit e grupit është ajo me Midtjyllandin më 1 dhjetor.

Djoković - Tsitsipas, gjysmëfinalja e dytë e ‘Roland Garros’

Përcaktohet kuadri i gjysmëfinaleve të “Roland Garros”. Pas Nadalit dhe Schwartzmanit, dy gjysmëfinalistët e tjerë, të cilët do të përplasen mes tyre, janë Djoković dhe Tsitsipas. Tenisti serb kaloi 3-1 me sete Carreno-Busta, në një duel që e nisi keq, duke e humbur setin e parë 6-4, por që shumë shpejt e ktheu në favorin e tij, duke triumfuar në tri setet pasardhëse 6-2, 6-3, 6-4. Nole u thye tri herë në shërbim në këtë përballje, dy herë në setin e parë, që i kushtuan humbjen, dhe në geimin e pestë të setit të tretë (gjithsesi e rikuperoi duke e thyer në shërbim dy herë kundërshtarin). Falë përvojës dhe qëndrueshmërisë fizike dhe psikologjike nuk e pati shumë të vështirë për ta kthyer shpejt rrjedhën e ndeshjes. Përmbushi pritshmëritë edhe Tsitsipas, që iu imponua në tri sete Rublevit, 7-5, 6-2, 6-3. Tenisti rus mundi të rezistonte vetëm në setin e parë, ku u thye në shërbim në geimin e 10-të dhe të 12-të, duke mos e shfrytëzuar faktin që kundërshtari grek gaboi në geimin e pesë (u thye në shërbim). Pjesa tjetër ishte e thjeshtë për Tsitsipas, që i fitoi të gjitha geimet me shërbimet e tij.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Petrol Company” sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për depon e lëndëve djegëse të lëngëta, impiantin për riciklimin e vajrave të përdorura dhe përpunimin e vajrave për ngrohje, qendrën grumbulluese të mbeturinave të plastikës dhe vajrave të përdorura me kod 160209* dhe vajrave ushqimor në Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.10.2020 në ora 10:00 në lokacionin ku gjendet deponia e karburanteve të “Petrol Company” në vendin e quajtur Miradi e Poshtme - Fushë Kosovë do të organizohet debat publik nga kompania “Petrol Company” sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për depon e lëndëve djegëse të lëngëta, impiantin për riciklimin e vajrave të përdorura dhe përpunimin e vajrave për ngrohje, qendrën grumbulluese të mbeturinave të plastikës dhe vajrave të përdorura me kod 160209* dhe vajrave ushqimor në Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4822467945?pwd=WVI4Uk1KTjhxdTlmTFV0Tk8vbU9VQT09>

Meeting ID: 482 246 7945
Passcode: 6rscxJ

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Gjej PUNË

• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► “Al-INOX” Sh.p.k me seli në Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 70843889 dhe numër UNIK: 810816465.

► Laureta Bytyqi shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.Mjekësisë "Hysni Zajmi" ne Gjakovë.

► Natyra Haxhiavdyli shpall te pa vlefshme dëftesat e kl.X,XI,XII dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

► Egzon Berisha shpall te pa vlefshme dëftesat e kl.X,XI,XII te Sh.M.Ekonomike "Kadri Kusari" ne Gjakovë.

► Remzije Xhevukaj shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M. Teknike "Shaban Spahija" ne Pejë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepe shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

Shtatë vite pa më të dashurin tonë



Skender Bytyqi

(08.04.1952 - 09.10.2013)

Mund të shkruaj për orë të tëra, por një gjë është e sigurt, asgjë nga këto që them apo shkruaj, nuk mund të jetë e mjaftueshme për të përshkruar dashurinë që kemi për ty.

Baba ynë i dashur, u bënë shtatë vite nga mungesa e jote fizike, por ti përherë mbetesh në mesin tonë, në kujtesën dhe zemrat tona. Edhe pse rrugëtimi ynë i përbashkët për ne ishte tepër i shkurtër, ti na edukove dhe na mësove shumë. Tani po vazhdojmë jetën pa ty, por me mësimet tua dhe përvojën tënde që na le trashëgim. Ne jemi më krenarët që të patëm ty si baba.

**Të kujtojmë me mall të pa shuar: Bashkëshortja Nazmija,
Vajzat: Ganimetja, Violeta dhe Shkurta
Djemtë: Gazmendi dhe Armendi dhe e gjithë familja**





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

